

FJALA E DEPUTETIT ILIR NDRAXHI

E ENJTE DATA 15 QERSHOR 2023

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji “Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencionet e peshkimit”, ka si qëllim miratimin e protokollit amendues për të përfshirë marrëveshjen për subvencionet e peshkimit në aneksin I të marrëveshjes së OBT-së që i ndalon shtetet anëtare të japin subvencione për anijet ose operatorët e përfshirë në aktivitete të paligjshme, të paraportuara dhe të parregulluara; për peshkimin e stokut të peshkut të mbipeshkuar dhe për rastet që kanë të bëjnë me peshkimin jashtë juridiksionit të një anëtari. Gjithashtu, synohet të adresohen shqetësimet e vendeve anëtare të OBT-së në lidhje me përfitimet e padrejta, që dëmtojnë konkurrencën e drejtë për ata anëtarë të OBT-së, të cilët mund të përballojnë të sigurojnë subvencione për industrinë e tyre të peshkimit. Ndalimi i subvencioneve në lidhje me mbikapacitetin dhe mbipeshkimin apo për stoqet e peshkut/rezervat natyrore të burimeve peshkore, që konsiderohen të mbipeshkuara /mbishfrytëzuara ose subvencione për mjetet lundruese apo operatorë të përfshirë në peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar ose për aktivitete të lidhura me peshkimin është në përputhje me politikat që ndiqen nga Shqipëria në fushën e peshkimit brenda zonës ekonomike ekskluzive. Nga kjo marrëveshje, bazuar në nenin 7 “Asistenca teknike dhe ndërtimi i kapaciteteve”, Shqipëria mund të përfitojë asistencë teknike nga OBT-ja për ngritjen e kapaciteteve me qëllim zbatimin e disiplinave, sipas kësaj marrëveshjeje. Në mbështetje të kësaj ndihme do të krijohet një mekanizëm financimi vullnetar i OBT-së në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare përkatëse, Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) dhe Fondin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë. Kontributet e anëtarëve të OBT-së për mekanizmin do të jenë ekskluzivisht në bazë vullnetare dhe nuk do të përdorin burime të rregullta buxhetore. Rregullat e marrëveshjes zbatohen për subvencionet që janë specifike për peshkimin e egër detar dhe për aktivitetet e lidhura me peshkimin në det dhe nuk kanë të bëjnë me akuakulturën dhe peshkimin në ujërat e brendshme. Vendeve më pak të zhvilluara dhe atyre në zhvillim u akordohet një periudhë prej 2 vjetësh pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, gjatë së cilës janë të përjashtuar nga zbatimi. Gjithashtu, marrëveshja imponon transparencë nëpërmjet njoftimit të rasteve të peshkimit të paligjshëm dhe parashikon riciklimin periodik të funksionimit të marrëveshjes nga një komitet i përhershëm, që do të krijohet për mbikëqyrjen dhe për monitorimin e kësaj marrëveshjeje, sipas përcaktimit të marrëveshjes. Marrëveshja parashikon dhënien e asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve të synuara për anëtarët e vendeve në zhvillim.

Projektligji “Për pranimin e protokollit për ndryshimin e marrëveshjes së Marrakeshit për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, marrëveshja për subvencionet e peshkimit” është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Marrëveshja për subvencionet e peshkimit nuk ka efekte financiare të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit. I ftoj kolegët që ta miratojmë këtë projektligj.